



UK Health  
Security  
Agency

**NHS**

# Hepatiti B

**Një udhëzues për  
kujdesin tuaj gjatë  
shtatzënisë dhe pas  
lindjes së foshnjës tuaj**



**i**mmunisation

mënyra më e sigurt për të mbrojtur  
veten dhe foshnjën tuaj





# Çfarë është në këtë fletëpalosje?

**4** Rezultati i testimit tuaj dhe çfarë do të thotë

**5** Çfarë është hepatiti B?

**5** Si u infektova me hepatit B?

**6** Planifikimi i kujdesit tuaj

**7** Monitorimi i trajtimit dhe kujdesit tuaj

**8** Kujdesi për foshnjën tuaj

**9** Programi i vaksinimit të foshnjës tuaj

**10** Kur shkoni në shtëpi

**11** Kush duhet të dijë?

# Rezultati i testimit tuaj dhe çfarë do të thotë



Së fundmi keni bërë disa analiza gjaku. Një rezultat ka treguar se ju keni një infeksion të quajtur hepatit B.

**Kjo fletëpalosje do të shpjegojë se çfarë është hepatiti B dhe çfarë do të thotë për ju, foshnjën dhe familjen tuaj.**

Kjo fletëpalosje përmban informacione rreth kujdesit që do t'ju nevojitet gjatë shtatzënisë për t'ju mbajtur të shëndetshëm dhe kujdesin e nevojshëm për foshnjën tuaj dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Gjatë shtatzënisë, për ju do të kujdeset një ekip specialist, i cili do t'ju shpjegojë të gjithë informacionin në këtë fletëpalosje, duke përfshirë detajet e kujdesit të disponueshëm aty ku jetoni dhe do t'i përgjigjet çdo pyetjeje që mund të keni ju ose partneri juaj.

Ekipi mund të përfshijë një mami të ekzaminimit të ekografisë, një infermiere specialiste, një mjek të specializuar në kujdesin e mëlçisë, një mjek obstetër, një farmacist dhe mjekun tuaj të përgjithshëm, infermierën dhe vizitoren shëndetësore.



## Çfarë është hepatiti B?

Hepatiti B është një infeksion i shkaktuar nga një virus. Një virus është një lloj mikrobi që mund të shkaktojë infeksione dhe sëmundje.

Virusi mund të shkaktojë shumë probleme me shëndetin tuaj, duke përfshirë inflamacionin (ënjtjen) e mëlçisë dhe mund të rezultojë në probleme të rënda të mëlçisë, që përfshin plagë (cirozë) dhe kancer. Mëlçia është organi më i madh në trup dhe shumë i rëndësishëm. Ajo kryen shumë punë duke përfshirë:

- pastimin e gjakut tuaj
- prodhimin e vrerit për të ndihmuar në tretjen e ushqimit që hani
- ruajtjen e sheqerit nga ushqimi juaj për t'ju dhënë energji

## Si u infektova me hepatit B?

Infeksioni i hepatitit B është më i zakonshëm në disa pjesë të botës. Një infeksion është një sëmundje që mund ta merrni nga dikush tjetër. Mund të përhapet edhe te personat e tjerë.

Virusi i hepatitit B gjendet në gjakun ose lëngjet e trupit të një personi të infektuar. Lëngjet e trupit janë gjëra të tilla si gjaku, sperma, pështyma dhe lëngjet vaginale.

Nuk përhapet me puthje, mbajtje për dore, përqaqim, kollitje, teshtitje ose duke ndarë enët dhe sendet e tjera të kuzhinës.

## Mund të përhapet në këto mënyra:

- nga nëna tek foshnja gjatë shtatzënisë ose lindjes
- gjatë seksit pa prezervativ
- nga ndarja e gjilpërave të infektuara ose pajisjeve të drogës
- nëpërmjet pajisjeve të pasterilizuara të përdorura me tatuazh, shpim trupi ose trajtim mjekësor ose dentar
- nga sasi të vogla gjaku që gjenden në furçat e dhëmbëve ose brisqet
- brenda familjeve (nga fëmija në fëmijë) në vendet ku infeksioni është i zakonshëm





## Planifikimi i kujdesit tuaj

**Është shumë e rëndësishme të kujdeseni për veten dhe të shkoni në të gjitha takimet tuaja.**

Ekipi i specialistëve do të punojë me ju për të planifikuar kujdesin tuaj gjatë gjithë shtatzënisë dhe lindjes.

### **Ata do t'ju japin informacione:**

- si ta mbroni foshnjën tuaj me vaksina (injeksione) në lindje dhe deri në 12 muajsh
- testimi për partnerin tuaj, fëmijët e tjerë ose ndonjë anëtar tjetër të familjes apo shtëpisë suaj

Do t'ju duhet të bëni disa analiza të tjera gjaku për të zbuluar se sa virusi i hepatitit B është në gjakun tuaj. Këto do të na tregojnë nëse keni një infektivitet më të ulët apo më të lartë.

Ne mund të planifikojmë më pas trajtimin dhe kujdesin më të mirë për ju dhe foshnjën tuaj bazuar në këto rezultate. Nëse niveli i virusit është i lartë, ekipi juaj i specialistëve mund t'ju kërkojë të merrni tableta për t'i mbajtur nivelet e virusit më të ulëta.

Ju gjithashtu mund të bëni një skanim për të kontrolluar shëndetin e mëlçisë tuaj.

Ne do t'ju shohim afër fundit të shtatzënisë për të diskutuar se çfarë do të ndodhë kur foshnja juaj do të lindë dhe për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni.

Hepatiti B nuk ndikon në mënyrën se si lind foshnja juaj. Nuk është një arsye më vete për të bërë një lindje cezariane.

Ju mund ta ushqeni foshnjën me gji në mënyrë të sigurt. Është shumë e rëndësishme që të merrni pjesë në të gjitha takimet tuaja pas lindjes së foshnjës për të mbajtur mirë veten dhe foshnjën tuaj. Ekipi është aty për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që keni ju ose familja juaj.



## Monitorimi i trajtimit dhe kujdesit tuaj

**Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar (UKHSA) ka një detyrë ligjore për të kryer mbikëqyrjen e sëmundjeve infektive të sëmundjeve të njoftuara, siç është hepatiti B. Kjo do të thotë vëzhgimi i virusit dhe sëmundjes për të parë nëse ai ndryshon dhe kontrolli se vaksina që përdorim vazhdon të funksionojë.**

Është e rëndësishme të dini nëse virusi është transmetuar tek foshnja juaj, kur dhe si ka ndodhur kjo. Për ta bërë këtë, ne do të kërkojmë lejen tuaj për të marrë mostra gjaku nga ju dhe foshnja juaj për t'i dërguar për analiza të specializuara:

Të gjitha gratë dhe foshnjat

- një mostër e vogël e gjakut tuaj në fillim të shtatzënisë
- një mostër e vogël gjaku nga foshnja juaj në moshën 12 muajshe
- nëse keni infektivitet më të lartë, na duhen gjithashtu:
- një mostër e vogël e gjakut pas lindjes së foshnjës tuaj
- 3 pika të vogla gjaku nga thembra e foshnjës tuaj në lindje\*

Më pas mund të krahasohet me testin e bërë kur foshnja është një vjeç dhe kjo do t'i ndihmojë shkencëtarët të kuptojnë se si po sillet virusi.

\*Shënim: Mostra e gjakut të foshnjës tuaj të marrë në lindje është e ndryshme nga testi 'shpimi i thembrës' i marrë kur foshnja juaj është 5 ditëshe dhe është shumë e rëndësishme që foshnja juaj ta kryejë edhe atë test depistues.



## Kujdesi për foshnjen tuaj

**Infeksioni i hepatitit B mund të parandalohet nëse siguroheni që foshnja juaj t'i bëjë vaksinat në kohë.**

Vaksinimet do të ulin shumë mundësinë që fëmija juaj të infektohet.

Foshnjat e lindura nga nëna me hepatit B kanë nevojë për mbrojtje shtesë. Injeksionet shtesë bëhen menjëherë pas lindjes së foshnjës tuaj dhe kur ai/ajo është 4 javë e 12 muajsh(e).

Nëse keni patur nivele të larta të virusit gjatë shtatzënisë, foshnja juaj do të ketë nevojë gjithashtu për një injeksion tjetër shtesë të quajtur imunoglobulina e hepatitit B (HBIG) menjëherë pasi të lindë.

Kur foshnja juaj të jetë 8 javësh, ata do të fillojnë vaksinimet rutinë të fëmijërisë që u ofrohen të gjithë fëmijëve. Këto përfshijnë vaksinën e hepatitit B.

### Mbani mend:

Në muajin e dymbëdhjetë, kur foshnja juaj ka i bërë të gjitha vaksinat, nevojitet një analizë gjaku për të parë nëse foshnja juaj ka apo jo infeksion të hepatitit B.





## Programi i vaksinimit të foshnjës tuaj

Foshnja juaj do të ketë nevojë për 6 vakcina gjithsej për ta mbrojtur atë nga hepatiti B. Është shumë e rëndësishme që foshnja juaj t'i marrë të gjitha.

### Vaksinimi 1 – hepatiti B tek

Para se foshnja të jetë një ditë në spital. Disa foshnja kanë nevojë për një injeksion të dytë të imunoglobulinës (HBIG) gjithashtu për mbrojtje shtesë.



1 ditë

### Vaksinimi 2 – hepatiti B tek

Në javën e 4-të – sigurohuni që ta keni regjistruar foshnjën te një mjek i përgjithshëm.



4 javë

### Vaksinimi 3

Në 8 javë kryhet vaksinimi rutinë i fëmijërisë që përfshin hepatitin B.



8 javë

### Vaksinimi 4

Në 12 javë kryhet vaksinimi rutinë i fëmijërisë që përfshin hepatitin B.



12 javë

### Vaksinimi 5

Në 16 javë kryhet vaksinimi rutinë i fëmijërisë që përfshin hepatitin B.



16 javë

### Vaksinimi 6 – hepatiti B tek

Në muajin e 12-të, foshnja juaj do të duhet gjithashtu të bëjë një analizë gjaku për të parë nëse ka hepatit B. Kjo është shumë e rëndësishme.



12 muaj



**Mos harroni të merrni librin tuaj të kuq në të gjitha takimet ose kujtojuani profesionistëve shëndetësorë që ta plotësojnë atë në internet.**

## Kur shkoni në shtëpi

### Regjistroni lindjen e foshnjës tuaj

Të gjitha lindjet në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut duhet të regjistrohen brenda 42 ditëve nga lindja e fëmijës. Nëse jeni e martuar, burri juaj mund ta bëjë këtë vetëm. Do t'ju jepet një certifikatë lindjeje.

### Regjistroni foshnjën tuaj tek mjeku juaj i përgjithshëm

Ju dhe foshnja juaj duhet të regjistroheni te një mjek i përgjithshëm për t'u siguruar që të merrni të gjithë kujdesin që ju nevojitet.

Regjistroni foshnjën tuaj sapo të lindë, në mënyrë që të mund të caktoni vaksinimin 4-javor të foshnjës. Do të jetë më e lehtë ta bëni këtë nëse keni certifikatën e lindjes. Tregojini mamisë ose vizitores shëndetësore nëse keni ndonjë problem me këtë gjë.

### Kujdesi në të ardhmen

Është e rëndësishme të mbani të gjitha takimet e bëra për veten dhe foshnjën tuaj, duke përfshirë çdo takim spitalor me ekipin e specialistëve.

Ju dhe foshnja juaj do të keni nevojë për një vizitë te mjeku juaj i përgjithshëm kur foshnja të jetë javëshe për të kontrolluar se gjithçka është mirë pas lindjes.

## Kush duhet të dijë për ju dhe fëmijën tuaj?

Ne duhet t'u tregojmë të gjithëve të përfshirë në kujdesin për ju dhe foshnjën tuaj se keni hepatit B, në mënyrë që të mund:

- të planifikojmë dhe japim kujdesin tuaj në mënyrë të sigurt
- të bëjmë të gjitha takimet që ju nevojiten me ekipet e specialistëve
- të bëjmë të gjitha takimet për kujdesin e foshnjës suaj dhe vaksinimet e ardhshme.

Ne kemi nevojë për lejen tuaj për t'u treguar profesionistëve të tjerë për ju, që keni hepatit B. Këto përfshijnë:

- mjeku i përgjithshëm (GP)
- vizitorja juaj shëndetësore
- Shërbimi i Informacionit për Shëndetin e Fëmijëve i cili regjistron të gjitha vaksinimet e foshnjës tuaj dhe rezultatet nga testet e shqyrtimit të të porsalindurve

Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar mbledh informacion për të siguruar që programet e ekzaminimit dhe të imunizimit janë të sigurta dhe efektive.

**Zbuloni se si Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar dhe Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (NHS) përdorin dhe mbrojnë informacionin tuaj në [www.gov.uk/phe/screening-data](http://www.gov.uk/phe/screening-data)**



# Informacione

## Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (NHS)

[www.nhs.uk/conditions/hepatitis](http://www.nhs.uk/conditions/hepatitis)

---

## Regjistrimi i lindjes së foshnjës tuaj

[www.gov.uk/register-birth](http://www.gov.uk/register-birth)

---

## Regjistrimi i foshnjës tuaj tek një mjek i përgjithshëm

[www.nhs.uk/using-the-nhs/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-practice/](http://www.nhs.uk/using-the-nhs/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-practice/)

---

## Të dhënat personale të shëndetit të foshnjës tuaj (libri i kuq)

[www.nhs.uk/conditions/pregnancy-and-baby/baby-reviews/#the-personal-child-health-record-red-book](http://www.nhs.uk/conditions/pregnancy-and-baby/baby-reviews/#the-personal-child-health-record-red-book)

